

Fillimet

Revistë e Shkollës së mesme "Vëllazërim - Bashkim"

Mars 2015, Nr.49



Vjet



Botues:

SH.M.K. "Vëllazërim-Bashkim"

Redaksia:

Albina Kasneci
Adelina Avdiu
Arnella Husenaj
Almeida Ceka
Blerta Nika
Driton Bajrami
Fjolla Murati
Gresa Muqaj
Yllka Nimanbegu

Realizimi Kompjuterik:

Ermelind Gjeçbritaj
Ammar Tivari
Valbona Resulbegu

Kryeredaktorët dhe Lektorët:

Nepe Peraj
Arian Mustafa



50
vjet

Përmbajtja:



4-5



18



8-9

- 3 #Fjala jonë
- 6 #Aktualitete
- 7 #Sëmundje aktuale
- 10-11 #Krijimtari
- 12 #Traditë
- 13 #Kulturë
- 14 #Kuriozitete
- 15 #Thënie
- 16 #Dukuri rinore
- 17 #Rrjete sociale
- 19 #Testamenti
- 20 #Fund

Fjala jonë

Ecim drejtë shtigjeve të jetës...
Duke iu përshëndetur me fundin tonë po ju lëmë
një "Fillim" të ri.

Me punën dhe përkushtimin tonë ia arritëm.
Kjo shkollë na ofroj plot katër vite në gjirin e saj.

Ne si redaksi u munduam që sadopak të
përmbledhim dhe t'i shfletojmë idetë tona
mbrenda kësaj reviste, duke dashur që me këtë
rast t'ju falënderjomë për të gjithë mundin dhe
përkushtimin që na ofruat.

Këtë vit shpërblehen:

Nxënësit më të mirë
në gjuhën shqipe

Nxënësit më të mirë
në gjuhën malazeze

| | | | |
|------------------|------------------|--------------------|------------------|
| Ema Milla | I ₅ | Sanja Llagator | I ₁ |
| Leudrita Mustafa | II ₂ | Kristina Junkoviq | II ₁ |
| Edona Çapriq | III ₄ | Sofija Kastratoviq | III ₁ |
| Arnella Husenaj | IV ₄ | Dajana Nikiq | IV ₁ |

Nxënësi më i mirë i shkollës

Ammar Tivari IV₃

Lexuesja më e rregullt

Jetmira Rexhoviq IV₅

50 vjet


E nëpërkëmbën me shekuj të tërë Ulqinin e bukur, vatër të Arbërisë. E mendoj dhe më vjen të qaj që shkolla ime nuk është aq e lashtë sa qyteti! Sot, 50 vite... U hapën për herë të parë dyert e arta të gjimnazit për të pritur dhe përcjellur mysafirët e të ardhmes së vendit. Mbetët enigmë se iniciativ e kujt është hapja e këtij gjimnazi, kujt duhet t'i dhurohen meritat. Sipas burimeve në vitin 1965 u formua gjimnazi në Ulqin, me mësim në dy gjuhë serbo-kroate dhe shqipe. Mësimi në atë kohë u zhvillua në hapësirat e shkollës "Boshko Strugar". Ndodh termeti dhe e shkatërron këtë ndërtesë. Pas vitit 1968 populli solidar i Bosnjës dhe Hercegovinës,

në shenjë solidariteti për dëmët e shkaktuara nga ky termet e ndërton këtë godinë si shkollë gjimnazi. Që atë ditë dhe sot quhet "Vëllazërim-Bashkim". Të rikthehemi në fillim të fillimeve, tek ata nxënës që u ulen për herë të parë në bankat e gjimnazit. Kanë kaluar shumë, kanë sakrifikuar shumë, për tu bërë sot mësues, profesorë e mjekë... Kemi pasur nderin që me disa prej tyre të bisedojmë. I nxitëm që të mendojnë për vitet e tyre të rinisë, i rikthyem me mendje atje ku kaluan kujtimet më të vështira, por që fituan përvojë më të vyera për jetën e mëtejme!

1965 – 1968
ndërtesa e vjetër e shkollës



1969 – 2015 →
ndërtesa e tanishme e shkollës



Nxënësit e parë që përfunduan gjimnazin në gjuhën shqipe ishin:

- Qamil Maroviq
- Ali Muçoviq
- Angjelina Ndrekiq
- Leonora Ndrekiq
- Rozina Ndrekiq
- Avdo Paleviq
- Nosh Camaj
- Muho Cekoviq
- Rasim Cucoviq
- Sabri Çapriq
- Daut Çausheviq



- Abedin Avdiu
- Ramazan Bardiq
- Cafo Boga
- Osman Daboviq
- Nikola Dukaj
- Rexhep Durakoviq
- Marash Gjurashaj
- Nreka Kolaj
- Avni Kurtoviq
- Reshit Llolla
- Daut Likaj
- Marko Lulgjura

arsim...
kulturë...
traditë...

Tregon z. Muho Ceka, profesor i historisë:


Pasi mbarova shkollën fillore, u drejtova shkollës së mesme, këtu në Ulqin. Ishte e vetmja shkollë e mesme shqipe në Mal të Zi. Edhe pse është quajtur shkollë shqipe, gjysma e lëndëve janë mësuar në gjuhën serbo-kroate. Është filluar me profesora që nuk e kanë njohur gjuhën shqipe. Gjë që për ne si nxënës ishte një vështirësi shumë e madhe. Në vitin e I^{te} ishin dy paralele në gjuhën shqipe me kujdestarët, Hasan Gorana, profesor i gjeografisë i cili jeton në SHBA dhe i ndjeri Ramo Dukaj. Nëse ke pasur në gjysmën e lëndëve notë të dobët në gjysëmvetor, ai nxënës ishte përjashtuar nga shkolla dhe për shkak të shpërnguljeve familjare në vitin e II^{te} mbeti vetëm një paralele. Vitin e III^{te} e vazhduan po këta nxënës, të cilët numëronin 21 vetë. Në vitin e IV^{te} erdhën edhe dy nxënës dhe këto 23 nxënës e përfunduan të parët gjimnazin në gjuhën shqipe. Ndërtesa e gjimnazit ishte një shtëpi e vjetër dy katëshe, pranë shkollës "Boshko Strugar". Më sa më kujtohet kur u regjistruam, si drejtor ishte Milica Vukoviq, profesore e gjuhës ruse, ndërsa kur u diplomuam Fadil Taipoviq. Me 1968 bie termeti dhe kjo shkollë shkatërrohet. Prej aty kemi kaluar në ndërtesën e shkollës "Boshko Strugar" për të vazhduar gjimnazin. Rrethanat ekonomike ishin shumë të vështira, banojshim nëpër shtëpi të ulqinakëve, sepse të udhëtonim çdo ditë ishte e pamundur. Bukë mangut kemi pasur, e mos të përmendim për veshjet. Nëse nxënësit e sotëm do ishin në rrethanat e kohës sonë, asnjëri prej tyre s'do të vazhdonte shkollimin. Prindërit e asaj kohe kanë hequr shumë keq për të na shkolluar. Dikush ka shitur një shportë vo, e ato para ja ka lënë fëmijut e është kthyer në shtëpi me xhepa bosh. T'iu tregoj juve këto gjera çka ne kemi përjetuar do ju duket si përrallë, që me zorë i imagjinoni sepse sot vendi, koha dhe njerëzit kanë ndryshuar aq sa s'të jep mendim të mendosh se "si ishte dikur"? Turni i mësimit është zhvilluar mbasdite, sepse disa nga personeli i shkollës nuk kishin kohë të ishin të pranishëm paradreke. Duhet theksuar se në mësim profesorët ishin të mangët, e si të diplomuar erdhën në vitë të katërt të nderuarit Ibrahim Ceka dhe Riza Rexha.



Z. Muhos i kujtohet ekskursioni që për to asaj kohe ishte një ëndërr e pa prekur, një gjë shumë e madhe: Ekskursioni ishte në Beograd dhe Sarajevë! Mbrëmjen e maturës e kemi mbajtur në hotelin "Galeb", ku do mbetet e fundit natë që ishim të gjithë së bashku, si gjeneratë e parë e gjimnazit! Aktivitete të lira pak kemi pasur, e nuk më kujtohet se kemi festuar ndonjëherë ditën e shkollës. Askush s'na ka folur për ditën e saj! Jam drejtuar profilit të arsimit vetë e nga eksperiencia dua të cekim që në raport me sot, me nxënësit personeli i shkollës i asaj kohe ka punur shumë më tepër. Kriteriumi ishte shumë më i ashpër, asaj kohe arsimtari kishte rolin e vet, e sot të gjithë i madh e vogël ka rolin e arsimtarit. Arsimtarin e kemi pas frikë, e nëse e kemi takuar në rrugë jemi larguar nga ai! Dikur fjala e tij është respektu dhe s'ka pasur zgjedhje tjetër e profesori është nderuar!

Në fund z. Muho shton:

"Punoni, mësoni dhe edukohuni për tu bërë e ardhmja e vendit. Shkollës së mesme dhe gjithë personelit të saj i dëshiroj punë të mbarë, dhe festoftë shumë e shumë jubilarë të tjera. E juve si MATURANTË ju dëshiroj fillime të mbara në studime!"



Në vijim z. Reshit Lolla, mjek, thekson:

Hapja e gjimnazit në Ulqin, një gjë shumë e rëndësishme për popullin shqiptar në Mal të Zi. Ishin kohëra të vështira dhe shumë interesante të viteve 1964/65. Ne në atë kohë, ne as vetë nuk ishim të vetdijshëm se çka donte të thonte të jemi gjeneratë e parë në gjuhën shqipe, kurse sot mbas gjysëm shekulli, mburrem që jam një ndër ato të parët. Ndërtesa e gjimnazit ishte vërtet e vjetër, nën murinjtë e Kalasë ballë për ballë me Kishën ortodokse. Në atë ndërtesë dy katëshe kaluam plot tre vite, derisa tërmeti i vitit 1968 e dëmtoi dhe u detyruam të shpërngulemi në shkollën "Boshko Strugar". Bankat gjithmonë i kemi pasur të hekurta dhe të mbuluara me dërrasa, me një fjalë solide, sepse ne nuk kërkonim luks por vetëm disa kushte të vulltshme për mësim. Të gjitha orët i kemi mbajtur në një klasë, profesorët merrnin me vete të gjitha mjetet e duhura për lëndë dhe përsëri i kthenin. Turni është mbajtur pasdite dhe kemi pasur 6 orë në ditë. Ne si nxënës ishim shumë të edukuar dhe profesorin e shihnim sikur "zot". E para gjë e rëndësishme për ne ishte të garonim për sjelljen shembullore e pastaj për mësim. Nxënësi më i dobët ishte me sukses "mirë", kurse gjithë të tjerët me "shumë mirë" dhe "shkëlqyeshëm". Në gjithë ne të asaj gjenerate jemi bërë dikushi, si inxhinjerë, ekonomistë, profesorë dhe unë mjek. Lëndët i kishim disa ne gjuhën shqipe, kurse disa të tjera në atë serbo-kroate. Lëndët si psikologjia, filozofia, arti, matematika dhe edukata fizike ishin ne gjuhën serbo-kroate, kurse gjuha shqipe, historia dhe bazat teknike ishin në gjuhën shqipe. Me sa mbaj mend profesor i filozofisë ishte Radovan Gjurishiq, i artit Pavle Mashanoviq, i bazave teknike Shaban Nuhiq, i historisë Hilmi Cungu dhe i gjuhës shqipe Ramo Dukaj. Nxënësit ishin më tepër nga Ana e Malit, Tuzi dhe Kraja. Udhëtimi nuk ishte aspak i lehtë dhe të gjithë ne kemi banuar në shtëpi private, gjëgjëisht në banesa qëndronim nga dy nxënës. Të shtunen pasdite ktheheshim në shtëpitë tona në fshat, gjë që ndodhte edhe të ecnim në këmbë nga Ulqini deri në Katërkollë.

Dhe për fund z. Reshiti shton i mallëngjyer: "Nuk mund t'ia fali vetes që nuk jam munduar të bëj një përvjetor të gjeneratës së parë të gjimnazit në gjuhën shqipe. Në bisedat që ende sot i kam me të gjithë shokët e klasës, të cilët i kam dashur dhe i dua, që më lidhin shumë kujtime dhe emocione, kemi shprehur dëshirën për tu takuar, por në asnjë mënyrë për tu bashkuar".

Rrezart Cungu

Filloi të merret me tenis që në moshën pesë vjeçare dhe aktualisht është anëtar i Klubi të tenist "Bellevue" nga Ulqini. Ai është kampioni junior i Malit të Zi i moshave gjër në 16 vjeç. Fitoi shumë turne, por mbi të gjitha është fituesi i Turneut në Avinjon (Francë), që në vitin 2002 e kishte fituar Novak Gjakoviçi.

Rrezart, të urojmë shumë suksese dhe vazhdo të korrësh fitore.



Jeton Osmani

Talenti i shkollës sonë Jeton Osmani është një ndër ping-pongistët më të mirë të Malit të Zi. Ai merret më këtë sport plot 4 vite dhe ka korrur sukses të madh. Një ndër ato është edhe turneu për garat kualifikuese në Londër. Poashtu, është shpërblyer me vendin e parë në Kupën e Podgoricës. Kemi nderin që në vendin tonë kemi një talent të tillë.

Të urojmë shumë suksese Jeton!



Vranina Mehmedi

Nxënsëja e shkollës sonë Vranina Mehmedi, mori pjesë në evenimentin "Miss Shqipëria 2014". Ky program u mbajt për herë të parë në Ulqin më 27 qershor 2014. Ajo fitoi çmimin "Miss Inteligjenca", pastaj hyri në Top 10 dhe arriti deri në finale. Me këtë shpërblim, iu dha mundësia të merrete pjesë dhe në Miss GLOBE 2014.

Vraninë, të urojmë suksese të mëtejme dhe le të jetë ky një fillim i mbarë për ty.




ANOREKSIA

sëmundje mendore apo trupore?

Anoreksia është një fenomen gjithnjë e në rritje, për të cilin kanë filluar të japin alarmin jo vetëm mjekët, por edhe e gjithë shoqëria.

Gjithnjë e më shumë shtohen rastet e prekjes nga kjo sëmundje, ku grupi më i prekshëm janë moshat 15-30 vjet, dhe kryesisht femrat... Anoreksia ose më mirë të shpreheshim ulja e oreksit, lidhet me shumë faktor të cilët nuk kanë lidhje me anoreksin nervore. Një gjendje gripale e zakonshme, sëmundja e aparatit tretës, gjendje depresioni apo stresi, apo sëmundjet e tjera të organizimit mund të çojnë në shfaqjen e problemit me oreksin. Simptomat më të zakonshme janë humbja e peshës të cilat tejkalojnë 15% të peshës që pritet të humbet.



A parandalohet anoreksia nervore?

Kjo patologji edhe mund të parandalohet në qoftë se kapet herët dhe jepet trajtimi i duhur. E rëndësishme është bashkëbisedimi dhe krijimi i marrëdhënieve të afërta prind-fëmijë, veçanërisht mes nënës dhe vajzës, për tu krijuar kjo e fundit besimin në vete.


Bashkëbisedimi edhe me një psikolog do të ndihmojë adoleshentën të kalojë vështirësit e moshës së sajë, duke e bërë të kuptojë se cila është mënyra më e mirë për të reaguar ndaj fenomeneve të ndryshme, siç mund të jenë ndryshimet në fizik...

Kur mund të dyshoni se dikush po zhvillon anoreksi?


Nëse shoqja apo shoku juaj fillon të pakësoj ngrënien e ushqimit dhe vakteve apo edhe aktivitetin fizik dhe fillon të shqetësohet shumë për pamjen e saj të jashtme, qëndroni vigjilent, pasi ky mund të jetë momenti kur ajo ose ai mund të nisë ta zhvillojë anoreksinë nervore.




Rrugëtimi ynë



EKSKURSIONI



PASAPORTË



PROZË

JETA

Jeta..., sa fjalë e fuqishme dhe domethënëse. Një labirinth i gjatë ku diku i ka rrugët e ngushta dhe të rrezikshme, e diku rrugët e saja janë të shtruara me pllaka të arta. Por ato rrugë përfundojnë.

Dikush mendon se jeta është një provë për të na provuar. Por unë mendoj se është një dhuratë për ta shijuar. Jeta është një letër e bardhë dhe e pastër, por gabimi më i vogël mund ta njollosë. Është një fije floku që shpejt bie nga koka. Është një laps që sa herë mprehet aq herë shkurtohet. Jeta ka dy sy që mbyllën shpejt. Jeta dikujt i sjell lumturi e dikush ndoshta vuan nga mundimi i saj. Ajo thjesht ecën dhe nuk ndalet, nuk të pret, vetëm ndërron shumë gjëra me ardhjen e saj. Ajo bart çdo freski, çdo aromë, bart çdo gjë të bukur dhe të keqe, ajo na dhuron çdo gjë.

Sidoqoftë e bukur apo e shëmtuar, jetën e dua. E dua, por në liri, atë liri që me vete sjell dëshirën për të kapur qiellin me dorë. Larg urrëjtjes mes njerëzve, varfërisë e luftërave, që secili njeri i bardhë apo i zi, të jetë vetvetja, dhe ta shijojë jetën në krahët e ëndërrave që fluturojnë!

Fjolla Murati

Zonjusha Jetë

E dashur mos qajë...!
Edhe pse ke lindur me lot, heshtë!
Shko atje larg me ëndrra fli,
por më prit.

Më prit, sepse vetëm ti i reziston
pritjes.

Je unë, por sa pranë të kam,
e s'të shoh...

As nuk të ndiej më interesantja!
Je me mua, e strukur diku thellë,
por s'bën zhurmë.

E unë? - Unë, qaj për ty!

Eh, zonjusha ime, - je femër,
sepse je tek unë.

Fluturon si zog nëpër qiell
me kënaqësi.

E di që këndon, por zëri
nuk të del,

Sikur ujën që etja e ka kapluar
e bukën uria e ka marrë

Edhe ty të mungon jeta
edhe pse vetë je ajo!

Pse qan!?

Je e përkohshme,
me mua do vish ngado,
gjer në vdekje.

Mos ke frikë nga ajo!

Ti flet e unë s'të kuptoj

Kjo më vret, por unë të dua
sepse, ti nuk bën pa mua

e as unë pa ty;

Të lutem, më jep jetë,
ta kuptoj që:

"Edhe pse s'të njoh,
je fryma ime,"

"Edhe pse s'të shoh
je shikimi im"

Edhe pse s'të flas
je zëri im

Vetëm për ty:

"Zonjusha jetë."

Allmedina Popoviq

Presim të nesërmen

Nuk keni shpresë

Se kjo mizori do të ketë fund
E drita do hap rrugë

Të rinj të ndrojtur

Më ideale të përealizuara
Presim ndryshimin që ka ngecur

Presim duarkryq

Se duart tona s'kanë fuqi
E fjalët përvlojnë si zjarr

Të prangosur e pashpresë

Presim sot që të zbardh e nesërmja
Vallë si do të jetë?

Apo ç'do herë do flemë gjumë

Të presim të vijë vetë

Ajdina Metanoviq

Diku

Dua të shkoj diku,

Në një vend plot magji

ku dielli veç lind e perëndim s'ka

ku ëndërrat bëhen realitetn

një vend ku lumturia mbizotëron.

Më ç'o atje,

Atje veç me ty dua të shkoj

Mjaft jetova në këtë botë të shthurur

po më zihet fryma,

s'mundem më në këtë botë.

Të shkojmë atje bashkë


të zbulojmë magjinë e asaj bote

Atje me ty, dua të rroj.

Miranda Maku

DETARIA


Tradita ...



Detaria, traditë e gjatë dhe e pasur e Ulqinit, rrjedh që nga Iliria e vazhdon deri më sot, ndërsa ulqinakët vazhdojnë të jenë detarë të shkathët e të guximshëm. Flota tregtare, që arriti kulmin në shekujt XVII, XVIII e XIX, lundronte nëpër të gjithë Adriatikun, Mesdheun e Levantin. Ulqini në këtë kohë ishte shtylla kryesore e Perandorisë Osmane. Përveç transportit të mallrave dhe sklevërve, kusaria ishte art për ulqinakët. Legjendat për kusarë, siç ishte Lika Ceni apo qëndrimi i Servantesit në Ulqin edhe sot e kësaj dite përkujtohen nga ulqinakët. Rreth 300 velanije ishin pjesë e flotës në fillim të shekullit të XVIII, ndërsa në shekullin pasardhës numri i tyre arriti në më shumë se 400.


Fundi i këtij shekulli e gjen flotën me rreth 150 anije, pastaj nën sundimin Parë Botërore i shkaktoi dëm të madh flotës, sa që pas luftës kishte vetëm pesë anije. Edhe pse flota pothuajse u shua, dëshira për të lundëruar mbeti e gjallë. Përveç lundërimit edhe ndërtimi i anijeve ishte art në vete i ulqinakëve. Ulqini kishte kantierin e vet të ndërtimit të anijeve i cili punoi deri në fund të shekullit XIX, ku kryesisht janë ndëruar velanije druri nga mjeshtra ulqinakë apo dalmatë. Gjithashtu si qendër e rëndësishme detare, Ulqini kishte edhe shkollën e vet të kapitenëve.

... vazhdon.



Sot nuk kemi një flotë të mirëfillët, por detarë të zot. Kemi kapitenë, drejtues makinash, oficerë dhe marinarë që

lundrojnë në të gjithë anët e globit. Ulqinakët kanë gjak detarësh që e trashëgojnë brez pas brezi, ajo çka i mungon është një shkollë e mirëfillët detarie. Sot, si çdo veprimtari ekonomike tjetër dhe detaria është standardizuar dhe kërkon ndjekjen hap pas hapi të teknologjisë. Kjo gjë e bën më të nevojshme hapjen e shkollës sesa tradita. Këtë vit udhëheqësia e shkollës sonë ka shprehur interesim për hapjen e degës së detarisë me dy drejtime: nautika dhe makineria e anijes. Edhe pse e merituar, vendimi i takon ministrisë përkatëse, normalisht dhe përkrahja maksimale e detarëve dhe mësimdhënësve të lëndëve detare. Gjithashtu një shkollë e tillë kërkon dhe kushte të veçanta, që kërkojnë dhe shpenzime të mëdha. Përveç shkollës një nevojë e madhe është dhe vendosja në funksion të plotë të marinës aktuale apo ndërtimi i një të reje.



MONUMENTET KULTURORE TË ULQINIT

Territori i Komunës së Ulqinit është i pasur me trashëgimi kulturore. Këtu po paraqesim disa prej tyre të cilat ende, vazhdojnë të mbesin të panjohura sa duhet dhe disa prej tyre të lëna plotësisht në harresë.

QYTETI I VJETËR I ULQINIT ka një histori të lashtë dhe të bujshme që fillon prej periudhave të lashta. Në periudhat e lashta, zhvillimin e madh si qendër urbane e arriti në periudhën e Shtetit Ilir. Gjatë mbretërimit të Agronit dhe Teutës qyteti i Ulqinit përfaqëson një qendër të rëndësishme të detarisë, traditë që do ta ruaj deri në ditët e sotme. Po kështu periudhat që do të pasojnë do të lënë gjurmë të dukshme në qytetin e Ulqinit. Sot Kalaja e Ulqinit është një prej monumenteve të rëndësishme dhe njëherit një prej qyteteve më të hershme të bregdetit lindor të detit Adriatik.



QYTETI I VJETËR I SHASIT përfaqëson vendbanimin më të hershëm të territorit të Komunës së Ulqinit. Jeta dëshmohet në këtë vendbanim të hershëm të Anës së Malit që në kohën e gurit të ri, gjërisht jeta këtu filloi rreth 8000 vite më parë. Sot Shasi përfaqëson një atraksion të vërtetë turistik. Në ambientet e qytetit të vjetër organizohet dhe manifestimi tradicional i Anës së Malit, njëherit dhe organizimi më popullor i Komunës së Ulqinit "Pranvera në Anë të Malit."





MUZEU ETNOGRAFIK DHE ARKEOLOGJIK

Në kuadër të qytetit të vjetër të Ulqinit, gjendet Muzeu i qytetit ku prezantohen koleksionet etnografike dhe arkeologjike të territorit të Komunës së Ulqinit.

SHTËPITË TRADICIONALE në territorin e Komunës së Ulqinit kanë qenë të ndërtuara me gurë. Në foto janë paraqitur dy shtëpi tradicionale të vjetra me dy kate, e majta në Anën e Malit, ndërsa e djathta në Kalanë e Ulqinit.

URA E KLEZNËS lidhte qytetin e Shasit me Shkodrën. Është ndërtuar rreth 300 vite më parë. Mjeshtri i cili e ka ndërtuar këtë urë ka qenë nga Dibra. Ai ka thënë se gëlqerja e cila do të përdoret për ndërtim duhet të qëndrojë në gropë 15 vjet.



A e dini se...



... **Bet'hoveni** para se të kompozonte fuste këkën në ujë, ndërsa **Ajnshtajni** deri në moshën 9 vjeçare nuk fliste normalisht?

... është vërtetuar shkencërisht që asnjë person nuk mund të **teshtijë** pa i mbyllur sytë?

... shenimet e para për vetitë kuruese të **marihuanës** datojnë që nga viti 2700 p.e.s. nga farmakopetë kineze?

... tërmeti më fuqishëm i regjistruar ndonjëherë, me një magnitudë **9.5**, ndodhi në **Valdivia** (Cili) në vitin 1960?

... një re mesatare kumuluse me vëllim **1 km³** peshon afërsisht sa **100 elefantë**?

... fjala **joga** vjen nga fjala sanskrite **yuj**, që në shqip do të thotë të **bashkohet**?

300 milion qeliza në trupin e njeriut vdesin çdo minutë, ndërsa?

... **prekja e mtekrres** së një burri tjetër në mesjetë ishte aq ofenduese sa që mund të shaktonte një dyluftim?

... çdo ditë një personi të zakonshëm i bien nga **60 deri 100 fije flokësh**?

... **selfie i parë** besohet të jet bërë nga fotografi Robert Korneilius në vitin 1839?

... **gratë e Egjiptit** të lashtë i kanë ruar vetullat në shenjë zie për **macet e ngordhura**?

... pasagjerët e **aerostatit të parë** kanë qene një dele, një patë dhe një gje?

... **aragostat** komunikojnë duke urinuar njëri-tjetrin?

... **peshkaqeni**, balenë mund ta fusë në njeri në gojën e ti por s'mund ta gëlltisë?

... **Islanda dhe Ishujt Faroe** janë të vetmit shtete ku **nuk ka mushkonja**?

... **trjeti merimangës** është pesë herë më i fortë se çeliku me peshë?

... **skeleti i njeriut** rigjenerohet çdo 10 vjetë?

... **takat për herë të parë** janë veshur nga meshkujt?

... një **mikrovalë** më shpejt e vëlon ujën sesa shkrinë akullin?

... **depresioni** mund të shkaktoj të ëndërrosh 3-4 herë më shume se normalisht?

Mendoni, përse...



SI E SHIHNI ... ?

Ngjyrë blu dhe të zezë

OSE

Ngjyrë anë dhe të bardhë...

Cila formë është **kiki** e cila është **buba**?



Përgjigja:

Asnjëra nga format nuk ka emër, por 95% e njerëzve pohojnë se **buba** është forma e majtë ndërsa **kiki** e djathtë?

Mendoni, përse...?

#Thënie

A
F
O
R
I
Z
M
A

“Nuk mësojmë për shkollë por për jetë.”

Seneka

“Njeriu i arsimuar dallohet nga i paarsimuari aq sa njeriu i gjallë nga i vdekuri.”

Aristoteli

“Gjërat të cilat natyra i ka përsosur janë më të mira se ato që i zbukuron arti.”

Ciceroni

Puna e jo përtacia është burim i lumturisë.”

Leon Tolstoj

“Çdo gjë që mund ta bësh ose mendon ta bësh, mos ngurro por fillo.”

Johan Volfgang Gëte

“Mos komando derisa të mos mësosh të dëgjosh.”

Sulejmani

“Ne nuk jetojmë për të ngrënë, por hamë për të jetuar.”

Sokrati

“Një ditë pa të qeshura, është ditë e çuar dem.”

Çarli Çaplin

“Pasuria më e madhe është pasuria e shpirtit.”

Profeti Muhamed

“Koha është një mësues i mirë, por fatkeqësisht i vret të gjithë nxënësit.”

Hektor Berlioz

F
J
A
L
Ë
T
Ë
M
O
Ç
M
E

Me mif n'Bun.

(të bëj punë kot)

S'i hahet arra pi dore.

(është i ndyrë)

S'i pren sakica n'nji vend.

(nuk është i fjalës)

Aja punë i vjen neto.

(e di atë punë mirë)

Ai nuk din se kush ja man krytin.

(është i marrë mendësh)

E ka bullarin n'xhep.

(është koprrac)

E ka gri horri.

(ka mbetur trokë)

E ka kalb' kanopin.

(e ka tepruar në diçka)

Flet karamaslith!

(flet pa lidhje)

I ban vedit me sy.

(narcist)

I ka cofë morri.

(s'ka më autoritet)

I shllinës e i litinës!

(i vuajtur, por trim)

Janë gjygyma t'fortë.

(janë të trashë nga mendja)

Ka shku timoni n'bash.

(ecën për së mbrapshti)

S'e din sa ban bastani?

(të mos merret vesh nga situata)

T'i tresin çelcat.

(të burgosin përjetë)

Mi ja la fytin.

(ta korrptosh)

Mas ma ban akull.

(të mos ja prishësh qefin)

Mashalla për mend!

(s'ka inteligjencë)

Me ba thuma.

(të jeshë në burg)

Hupsh çinimaçin!

(zhduku e mos u kthe)



NDIKIMI I MEDIAVE NË MENDIMIN DHE SJELLJEN TONË

Me krijimin dhe zhvillimin e teknologjisë, bota e njerëzimit ka marrë anë tjetër. Teknologjia është ajo që ka pushtuar gjithë mendjet tona.



Sipas konkluzioneve që kanë nxjerrur, teknologjia e sotme ndryshe mund të quhet edhe "kontroll i mendjes sonë".

Për fat të keq, teknologjia sot në botë ka zërë një përqindje të madhe. Kjo bën që ne të harrojmë edhe se çfarë duhet edhe është e drejtë të bëhet. Ku janë librat sot? Shumë pak njerëz lexojnë, sepse sot ka mjete tjera për ta ushqyer trurin. Po letrat që dërgonin dikur të parët? Edhe ato janë zhdukur, sepse sot ka mjete të cilët e bëjnë më të lehtë komunikimin. Po sikur të provonim një ditë të jetonim pa to. Të mos i afrohem kompjuterit dhe të fiknim celularët, e në vend të tyre të lexonim e të punonim duke u argëtuar në gjirin e familjes dhe të shoqërisë, do e vërenim se sa më bukur do të ishte jeta. Por e di që kjo ju duket qesharake dhe ajo që ne duam të tregojmë është se mendja jonë është në një kontroll të vazhdueshëm.

Teknologjia nuk po përdoret siç duhet e as nuk po na hyn në punë aq sa ne mendojmë. Po shkatërron mendjet tona dhe do vazhdoj ta bëjë. Kjo do të çojë deri në shkatërrim dhe e vetmja pyetje që na lind është:

Kush është fajtor për këtë?



Instagram



INSTAGRAM është rrjetë sociale që mundëson shpërndarjen e fotografive dhe videove. Sot ky rrjet po përdoret në masë të madhe, dhe u llogariten që aktualisht të jenë rreth 300 milionë përdorues aktiv të këtij aplikacioni.

Në trend:

- Weekend
- Hashtag
- Project
- Throwback
- Thursday
- Selfies



Përgatiti: Valbona Resulbegu



snapchat

SNAPCHAT është një aplikacion ku mesazhi është vetë fotografi. Me përdorimin e këtij aplikacionit përdoruesit mund të bëjnë foto, të ingjizojnë video, shtojnë tekste dhe vizatime, dhe ti dërgojnë tek përdoruesit e tjerë. Rreth 200 milionë persona janë përdorues aktiv të tij.



Redaksia



ADD US!



Për juooo

Secili nga
ju është i veçantë në
mënyrën e vet, por ne si maturan të kemi
veguar tek ju disa nga këto tipare:

Profesori më me stil

Fatbardhe Katana
Edin Kapllani
Osman Shurdha

Profesori më i dashur

Bilal Nikeziq
Fatbardhe Byzyku
Izeta Hamsiq

Profesori më i kuptueshëm

Hyrije Hoxha
Islam Hoti
Kadri Sinani

Profesori më simpatik

Ali Muça
Daut Doda
Kile Husenaj

Profesori më i mirë

Ali Doda

Profesori më strikt

Elez Muja
Remzije Rejzi
Luljeta Haxhibrahimi

Profesori më i buzëqeshur

Ahmet Markashi
Blendi Maxharri
Nail Asllani

Profesori më aktiv

Arijeta Ibroçi
Rasim Muja
Skender Muça

Profesori më i shoqërueshëm

Rrok Lulgjuraj
Valdet Kurti
Lila Rabrenoviq

Praktikantja më e mirë

Jetmira Çobaj Nikeziq

T E S T A M E N T I

Shumë vite t'katërta ktu ka pas e shumë tjera kajn me kalu por larmin e gjeneratës ton zor se keni mi harru.

Na prej gjumit sa jena çu t'paren ke dera shkollës diktatoren e kena taku. Kyt Dobrillen tan e kena drasht, prej tmadh e tvogel Amin e ke pas. Kurr dekikun sna ka fal e at der na ka plas per ball.

Kajher besa edhe jena gzu se kafer per ball i kena vizitu. "Minusin" nshkoll na kan vu po me "plus" nkafe e kena zavendesu.

Dikur bela edhe kena mu penu po njikshtu rinin e kena kalu, boll per drej kena qen, e tesh edhe nja dy fjal pa ju lam njiktu mren.

Pa fillom prej **Ahmetit**, burr i fort e zotni po kyt matematiken asesi nkry me na shti. Lop e bakti boll na ka than po kurr per t'madhe sja kena xan. Edhe nor kur skena shku Meti jon na esht terbu sa edhe n'kafe ka ardh me na kërku. Nji munges qe e bashim edhe at me gjak e lashim.

E ka pas nji kojshi t'vocerr boll t'lezeçme e për hater, **Kilen** ton t'biologjis që e kena dasht e begenis.

Tesh pa dalim te shkenca tjeter kyt kimin e kena dasht teper, kja **Fatbardha** boll esht mundu po kurr eksperimentet sna ka kallxu, kohen e funit esht permisu qe si shoqe na ka kuptu.

Kja **Arjeta** zonj e rand, ne anglisht na ka dhan, n'or pa libra s'ke ba me shku se perjashta ke fluturu. Boll anglishten na ka msu sa kurr sesht nal me pushu.

Pa vazhdom te gjuha tjeter, ky **Gazmiri** i lezeçem. N'or tij lezet me shku, po gjermanishten s'dona mi msu. Edhe ky boll esht mundu po sdi se kush e ka nigju.

Shqipen ton, me **Islamin** pa e msom,e bela njikyt spa e harrom. "çu çu njiher" e "boll tesh ma" njita fjal kurr sja ka da. Si vlla t'madh e kena pas gjithmon t'miren na ka dasht, malli shum ka me na marr sa edhe n'gjum ka me na dal.

Tjeter prof me na percjell kja **Izeta** na ka zgjedh, boll e mir edhe kja po telefonash sju ka da, nji sat e nji neser hajt se ju kthej periudhen tjeter. Me proverba e fjal turta na ka majt ky **Rasim Muja**, n'or tij kur kena shku

esht dasht perpara mu relaksu se tan oren ka spjegu.

E nji tjeter kur kalan perbri i gaditun si zotni, qe n'tan shkollën veç parfemi i tij esht ni, at za pa e hallan "hajdni hajdni nor" **Nalli** pa na knan.

Na prej gjumit sa u çoshim nhistori te **Bardha** shkoshim, as kja moden se ka lan pergjithdit me kanji stil t'ran.

Edhe **Blendi** djali i ri e simpatik, edhe ky ka ra teftik. Njat piano fart e dan po gratis kurr spa na knan. Per revist kur u mlodhme me shkru tha "mas shkruni gja per mu se si specat kam me ju qeru."

Burr e gru thojn mish e thu, ashtu edhe **Kadrija** me **Rrokun** kan shku. Njeni ka shkru e tjetri ka ushtru, tan jeta n'njat sall ju ka shku. Ky Rroku boll esht plak, po kur dan mu nal ma mar nafak?

Boll munohet me na msu, qe daj gja per doret me na shku, her per tmir e her per tkeq del Kadrija si per drej.

N'galeri fort kena shku, asnji ekspozit skena lan me kalu. Me **Edinin** e **Bilalin** mir kena kalu, jena marr vesht vec tuj u shiku. Vizatim kur na i kan kontrollu shum mir gjithmon katersha kan dasht me na vu po pesen kurr se kan tradhtu.

Ky **Valdeti** informatik me logaritma na ka fik. Tana ort kur kena shku kompjuterat kajn blloku, edhe pse demek tri na i kan pru.

E ta pak ma t'moçmit spa i permemin as per tmir as per t'keq se huqin vec e kajn nen vesh. Me ju sha skena dasht po as me ju livdu ju sna lat. "Mas m'permen njeni, mas m'permen tjetri" sdi se si na bat per veti. 4 vjet me ju i kalume, bela daj fjal t'mir i meritume, gja si kurr ju nuk na than, e gjithmon tki na bat.

E na ktu kerken nuk kena sha tanve t'mir ju kena ba, bela edhe se keni meritu,po na me huq sdonu mu largu!

Ma kishim pas me shkru per ju,po fleta ven sna ka premtu,e per disa s'ditme ca me shkru se nxansat tjer sna kan nimu!

E hajt tesh se boll e ka pas se edhe na me ju kena plas!

Mirëpafshim...

Jeta është si një roman ku kopertinat e saja janë jeta dhe vdekja, ndërsa fletët në mbrendësi të atij romani janë ditët tona. Ajo është një sfidë që duhet sfiduar, një sprovë që duhet kaluar, një problem që duhet zgjidhur, një avanturë që duhet shijuar por mbi të gjitha ajo është e bukur dhe e shtrenjët, ndaj duhet jetuar deri në maksimum. Një roman i pashkruar që askush nuk ia nxorri përfundimin, i ngatërruar në çdo kapitull dhe faqe të tij, pa kuptim, pa titull, pa autor. Kjo është jeta, një udhëtim që nga djepi e gjërë tek varri, që të gjithë duhet ta jetojmë, ta gëzojmë. E gjithë kjo kalon si nëpër ëndërr e pas kësaj mbetë imazhi dhe kujtimi. Përse sot nuk mund të qeshim? Përse sot lot po qesim? Një ndjenjë pikëllimi sot na ka kapluar, ndarja shumë është duke na muduar. Plot katër vite kaluam bashkë, njëri-tjetrin vërtet e kemi dasht. Kaloi sikur ëndrra më e bukur e jetës sonë, e shoqëruar me momente gëzimi e hidhërimi me të papritur me lot e buzëqeshje. "Ato emra që në banka i shkruam, ato detyra që në mure i kopjuam, ato fjalë që njëri-tjetrit i tham, ato grindje që ndonjëherë i bamë, ato ikje nga orët e mësimi, ato britma nëpër korridore, ato gëzime, ato hidhërimi të gjitha këto mbetën kujtime". Duhet pajtohemi me thënien se çdo fillim e ka një fund! Ky muaj i festave, ky maj i bukur, që çdo vit na dhuronte gëzim, sot po na mbush me trishtim. Ah, sa do të donim ta kthenim kohën pas, kohën kur gëzimi dhe hareja për ne ishin në një vend, kur çdo gjë ishte e zgjidhshme, e bukur e këndshme, dhe e paharruar. Ambienti, shoqëria, mësimdhënësit dhe të gjithë njerzit e tjerë që na rrethojnë... Tani mbaroi ajo jetë, si dita me ardhjen e hënës, u formuan ato ditë dikur kur ishim nxënës, mbaruan ato biseda, u harrua çdo send, kur gëzimi dhe hareja për ne ishin në një vend, ato s'kthehen përsëri me shumë mall i kujtojmë dhe jeta ecën pa frenim por ajo që shkon mbetët gjithmonë kujtim, e dinim se jeta surpriza na premtonte por se jeta shkollore shumë shpejt po mbaron. Oh, Zot sa kanë për të na munguar, lojërat, qortimet, këshillat e mësimdhënësve që gjithmonë mundoheshin që ta na udhëzonin drejt rrugës së drejtë dhe të duhur për ne. Të flasësh për këtë shkollë, për këto mësimdhënës, punëtorë e nxënës s'ka të mbaruar, s'ka fjalë për ti përshkruar, do të ma duheshin orë, ditë e javë për të shkruar. Do të na duheshin fjalët më të bukura që ekzistojnë, ato për ti përshkruar. Do të donim të mos largoheshim, të qëndronim me orë të tëra duke iu treguar për përvojat, momentet e bukura e të hidhëruar që kaluam gjatë këtyre viteve shkollore. Tani me lot në sy e me buzëqeshje në buzë falënderojmë për mirëkuptimin, tolerancën dhe ndihmesën që keni treguar ndaj neve.

*Të gjithëve ju urojmë
shëndet, paqe dhe harmoni në jetë.*